



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit:22.13.1-2015-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT VJETORE FINANCIARE TË KOMUNËS SË
RAHOVECIT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015

Prishtinë, qershor 2016

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare, dhe operative. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratë publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për tu kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne po rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe po luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Rahovecit në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrë auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Florim Beqiri, i mbështetur nga Mehmet Muçaj (udhëheqës i ekipit) dhe Shpresa Zenelaj (anëtare).

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
2 Qeverisja.....	11
3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.....	17
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	29
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	30
Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak	33


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunës së Rahovecit (më tutje: komuna) për vitin 2015, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderojmë Kryetarin e Komunës për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2015 u ndërmor në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit në Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat kemi menduar se janë të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me Pasqyrat Vjetore Financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, të datës 18.11.2015.

Auditimi ynë është fokusuar në:



(Më hollësisht, shih shtojcën I të këtij raporti):

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2015 është përcaktuar nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:

“Opinion i Pamodifikuar me theksim të çështjes”- sepse pasuritë e komunës ishin nënvlerësuar për shkak se në regjistrat kontabël nuk ishin regjistruar 120 hektarë toka bujqësore dhe 8 lokale të komunës si dhe ishin nënvlerësuar investimet në vijim për 352,871€.

Përveç kësaj, komuna ka bërë keqklasifikim të shpenzimeve, ku nga kategoria e investime kapitale kishte paguar për mallra dhe shërbime, subvencione dhe bashkëfinacime të cilat ishin të planifikuara me buxhet.

Formulimi i plotë i opinionit është dhënë në hollësi të nën kapitulli 1.2 i këtij raporti.

Konkluzioni i përgjithshëm

Sistemi i kontrollit të brendshëm në aspektin e raportimeve në nivelin e tanishëm nuk ofron sigurinë se aktivitetet operative dhe financiare të komunës kryhen në mënyrë efektive, dhe si i tillë, ka nevojë të ketë një mbikëqyrje të shtuar dhe përmirësim në disa fusha.

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



Dobësit sistematike në prokurim, janë karakterizuar me lidhje të kontratave përtej ndarjeve buxhetore dhe zhvillim të procedurave të prokurimit jashtë planit



Kryetari duhet të kryejë një rishikim të brendshëm për të përcaktuar pse kërkesat e prokurimit nuk janë adresuar në të gjitha rastet e prokurimit dhe të ushtrojë më shumë kontrole për të siguruar se dobësitë sistematike të identifikuara janë adresuar (shih çështjen 8 dhe 9)

Përgjigjja e Menaxhmentit në auditimin e vitit 2015

Kryetari i Komunës ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit në këtë raport, si dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet e dhëna.

Ne konsiderojmë si të kryer faktin që Kryetari:

- Do t'a shqyrtoj raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- Deri në fund të muajit janar 2017, ta diskutoj në Asamblenë Komunale progresin lidhur me implementimin e planit të veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PVF e vitit 2016 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave.

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PVF. Ne gjithashtu, shqyrtojmë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata për prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.2 Opinioni i Auditimit

PËR KOMUNËN E RAHOVECIT

OPINION I PAMODIFIKUAR ME THEKSIM TË ÇËSHTJES

Ne kemi audituar Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Rahovecit për vitin e përfunduar me 31.12.2015, të cilat përfshijnë Pasqyrën e Pranimeve dhe Pagesave në Para të Gatshme', 'Pasqyra e Krahasimit të Shumave Buxhetore dhe Aktuale', Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Vjetore Financiare si dhe Shpalosjet.

Sipas mendimit tonë, Pasqyrat Vjetore Financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale, të pranimeve dhe të pagesave si dhe të buxhetit të realizuar të Komunës së Rahovecit për vitin e përfunduar më 31.12.2015, në përputhje me: Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme); Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullën Financiare të Ministrisë së Financave nr. 03/2013/ për Pasqyrat Vjetore Financiare të organizatave buxhetore.

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa për Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të Pasqyrave Vjetore Financiare të Organizatave Buxhetore në Kosovë, ZAP është i pavarur nga Komuna dhe përgjegjësitë e tjera etike janë

përmbushë në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Theksim i Çështjes

Dëshirojmë të tërheqim vëmendjen se Regjistri i Pasurive Fikse nuk konfirmon gjendjen e plotë të pasurive, sepse në totalin e pasurive (52,206,159€) nuk ishin përfshirë 120 hektarë toka bujqësore, 8 lokale të komunës, si dhe ishin nënvlerësuar investimet në vijim për 352,871€ për shkak se 16 pagesa për projektet të ndryshme ishin regjistruar në regjistrin kontabël si shpenzim, por jo edhe si investime në vijim.

Komuna kishte bërë keqklasifikim të shpenzimeve ku nga kategoria e investime kapitale kishte paguar 395,732€, prej të cilave: 224,547€ ishin për mallra dhe shërbime, 48,351€ ishin për subvencione dhe transfere dhe 122,834€ sipas marrëveshjes së bashkëpunimit me Caritas Kosovën. Arsyeja e keqklasifikimit ishte planifikimi jo i mirë i buxhetit për kategori ekonomike. Përveç kësaj, 87,000€ pagesa nga palët e treta, nuk janë regjistruar në SIMFK. Opinioni i Auditimit nuk është modifikuar në lidhje me këto çështje.

Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe Pasqyrat Vjetore Financiare

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të PVF sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme, si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e PVF pa keqdeklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për Pasqyrat Vjetore Financiare në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe ta planifikojmë dhe ta kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse pasqyrat financiare nuk kanë keqdeklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse Pasqyrat Vjetore Financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi, Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keqdeklarim material kur ajo ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave vjetore financiare.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e Pasqyrave Vjetore Financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi e përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të Pasqyrave Vjetore Financiare.

1.3 Rreziqet domethënëse në PVF

Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, të datës 18.11.2015, janë identifikuar tri rreziqe për PVF-të. Këto janë rreziqe të keq deklarimeve materiale, të cilat mund të rezultojnë në modifikim të opinionit ose në theksim të çështjes. Rreziqet e identifikuara kanë të bëjnë me palët e treta, mungesa e regjistrit të plotë të pasurisë, dhe klasifikimin e gabuar të shpenzimeve.

Rreziku i regjistrimit të pasurisë – Komuna kishte adresuar rekomandimin për regjistrim të pasurive, por nuk kishte arritur ende që të krijoj një regjistër përfundimtar. Në këtë kuptim, komuna i kishte mbivlerësuar investimet në vijim për 85,920€ duke regjistruar dy herë pagesat e njëjta për projektet “Ndërtimi i rrugëve në Komunën e Rahovecit dhe kanalizimi në fshatin Pastasel” si dhe kishte nënvlerësuar investimet në vijim për 352,871€ për shkak se 16 pagesa për projektet të ndryshme ishin regjistruar si shpenzim në regjistrin kontabël, por jo edhe si investime në vijim.

Rreziku i keq klasifikimit - Ne kemi identifikuar që menaxhmenti nuk ka ndërmarr veprime konkrete për të adresuar rekomandimin lidhur me keq klasifikimin e shpenzimeve. Nga kategoria e investimeve kapitale janë kryer pagesa në vlerë totale 395,732€ për mallra dhe shërbime (224,547€), subvencione transfere (48,351€) si dhe sipas marrëveshjes së bashkëpunimit me Caritas Kosova (122,834€). Vlen të sqarohet se shuma prej 395,732€ ishte e aprovuar me tabelat buxhetore të Buxhetit 2015 për investime kapitale, por projektet e paraqitura në tabela, nuk përmbushin kushtet të trajtohen si projekte kapitale, dhe gabimet kanë të bëjnë me planifikimet fillestare nga komuna dhe aprovimet jo adekuate nga ana e MF.

Rreziku i tretë domethënës që ka të bëjë me prezantimin e pagesave të palëve të treta, në aspektin e prezantimit në PVF nuk është materializuar sepse menaxhmenti pas sugjerimeve tona (derisa ishim në terren) ka ndërmarr veprimet e duhura duke regjistruar 87,000€, pagesa nga palët e treta. Por, të njëjtat regjistrime nuk ishin proceduar edhe në SIMFK, siç parashihet me procedurat për regjistrimin e granteve të përcaktuara të donatorëve në Kosovë.

1.4 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të veproj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren Financiare MF nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me plotësime dhe ndryshime);
- Pajtueshmërinë me kërkesat buxhetore;
- Raportimet tremujore në Kuvendin Komunal; dhe
- Planin e prokurimit

Në kontekst të kërkesave për raportim, ne nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi.

Draft PVF-të fillimisht përmbanin disa gabime materiale. Pas rekomandimit tonë, pjesët ku ka qenë e mundur të intervenohet janë korigjuar mirëpo pasqyrat ende përmbajnë disa gabime si:

Çështja 1 – Gabimet në PVF - Prioritet i lartë

E gjetura

Komuna nuk kishte regjistruar në SIMFK 87,000€ si pagesë nga palët e treta;

Nga kategoria e investimeve kapitale janë kryer pagesa në vlerë totale 395,732€ për mallra dhe shërbime (224,547€), subvencione dhe transfere (48,351€) si dhe sipas marrëveshjes së bashkëpunimit me Caritas Kosova 122,834€; dhe

Në nenin 16 shpalosja e pasurive - Komuna, pasuritë komunale i ka prezantuar në shumë 52,206,159€, derisa ne identifikuam që në këtë shumë nuk ishin përfshirë 120 hektarë toka bujqësore, 8 lokale komunale si dhe 16 pagesa për investime kapitale që ishin bërë në vitin 2015 në shumë prej 352,871€.

1.5 Rekomandimet

Rekomandimi 1 Prioritet i lartë - Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2016 i adreson të gjitha çështjet e ngritura, përfshirë rreziqet domethënës për keq klasifikim të shpenzimeve dhe shpalosjen e pasurive. Kjo, gjithashtu, duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe fushat ku janë identifikuar gabime.

2 Qeverisja

2.1 Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për komunën që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo është një tregues nëse menaxhmenti është i përkushtuar t'i përmirësoj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetëvlerësimit që është plotësuar nga komuna siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një organizatë individuale buxhetore të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Rishikimet tona kanë identifikuar disa mangësi në fushën e qeverisjes së mirë, të cilat janë paraqitur më poshtë.

2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda komunës veçanërisht në lidhje me menaxhimin e rrezikut, zbatimin e objektivave strategjike dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Lista kontrolluese e vetëvlerësimit, e plotësuar nga komuna, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht, me disa komente pozitive mbi aranzhimet ekzistuese që nuk bazohen aq sa duhet në dëshmi. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si përgjigjja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit dhe operimi i një sistemi të auditimit të brendshëm në nivel më cilësor nuk janë të vendosura.

2.3 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2014, ka rezultuar me 16 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të implementohen rekomandimet. Ne vlerësojmë se menaxhmenti ende ka nevojë të forcoj procesin e llogaridhënies së menaxherëve në zbatimin e rekomandimeve.

Është për t'u vlerësuar fakti se Raporti i auditimit për PVF e vitit 2014 ishte diskutuar edhe në Kuvendin Komunal me datën 31.08. 2015, çka ndikon në rritjen e transparencës dhe shqyrtimin më kritik të aktiviteteve të komunës

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2015, katër (4) rekomandime ishin implementuar, pesë (5) ishin adresuar dhe janë në proces të implementimit dhe shtatë (7) nuk ishin adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 2 – Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

E gjetura Komuna ka implementuar vetëm një pjesë të rekomandimeve të vitit të kaluar. Kjo, për shkakun se nuk është ndjekur ndonjë proces formal për adresimin e tyre si dhe nuk është monitoruar në tërësi procesi i implementimit të rekomandimeve sipas planit të veprimit.

Rreziku Dobësitë e përsëritura të kontrolleve të menaxhmentit në sistemet financiare dhe fushat tjera të veprimtarisë kanë rezultuar me:

- Projektet kapitale të mos planifikohen në mënyrë të duhur, duke ndikuar që komuna të hyjë në obligime më shumë se sa ndarjet buxhetore;
- Në keq klasifikimin e shpenzimeve në kategori ekonomike jo adekuate;
- Shmangie në disa raste nga kërkesat standarde në procesin e prokurimit; dhe
- Performancë jo e mjaftueshme nga NJAB dhe aktivitet i mangët i komitetit të auditimit të brendshëm.

Rekomandimi 2 Kryetari duhet të forcoj masat e kontrollit dhe të përgjegjësisë ndaj personave të ngarkuar për adresimin e plotë të rekomandimeve që veprimet e parashikuara me plan veprimi të zbatohen, në veçanti në fushat e identifikuara me shkallë të lartë rreziku dhe brenda afateve të përcaktuara.

2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vetë-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Në kuadër të këtij auditimi, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorit të vetëvlerësimit të MFK-së të dorëzuar në MF. Më poshtë ne kemi përmbledhur gjetjet tona për komunën. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetëvlerësimit, por do të paraqes gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për t'i mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 3 – Lista kontrolluese e vetëvlerësimit – Prioritet i lartë

E gjetura Si pjesë e auditimit tonë, kemi shqyrtuar disa pyetje kyçe të pyetësorit të vetëvlerësimit në lidhje me pesë komponentë. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

1. Komuna ka një strategji të miratuar që nga viti 2009 pa ndonjë afat kohor. Neve nuk na është ofruar ndonjë dëshmi që tregon se strategjia është diskutuar me menaxherët e organizatës buxhetore dhe palët e treta jashtë komunës; si: grupet e interesit, shoqëria civile, qytetarët etj. Po ashtu, nuk dihet kostoja e kësaj strategjie;
2. Procedurat e duhura për menaxhim të rrezikut nuk janë vendosur dhe kjo është trajtuar në hollësi në nënkapitullin 2.5.1; dhe
3. Progresi lidhur me arritjen e objektivave nuk monitorohet rregullisht dhe nuk analizohen shkaqet për dështimet e mundshme në këtë drejtim.

Rreziku Aranzhimet e dobëta të qeverisjes i dobësojnë proceset strategjike dhe operative dhe e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.

Rekomandimi 3 Kryetari duhet të sigurojë se plotësimi i listës kontrolluese të vetëvlerësimit të jetë më kritik dhe të siguroj adresimin e fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të rishikohet mundësia e azhurnimit të strategjisë së zhvillimit komunal e cila do të përfshinte objektivat e qarta dhe arritjen e synimeve komunale. Po ashtu, të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për të siguruar dëshmitë mbështetëse lidhur me pohimet e vetëvlerësimit..

2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit komuna operon dhe sfidat me të cilat përballet.

2.5.1 Vlerësimi i rrezikut

Komuna pritet të zbatoj vlerësimin e rrezikut. Udhëzimet e përcaktuara në procedurat e MFK-së kërkojnë që regjistri i rrezikut të jetë i kompletuar, për të mbështetur menaxhimin efektiv operacional dhe strategjik.

Çështja 4 - Moszbatimi i kërkesave për Menaxhimin e rrezikut – Prioritet i lartë

- E gjetura** Pyetëtori i vetëvlerësimit i plotësuar nga stafi komunal ka rikonfirmuar se në disa raste merren në konsideratë rreziqet, por komuna ende nuk ka identifikuar rreziqet në formë të shkruar të cilat do të kanosnin arritjen e objektivave dhe reagimet në rast të ndodhjes së tyre.
- Rreziku** Mungesa e menaxhimit efektiv të rrezikut do të zvogëlojë mundësinë e menaxhmentit për të marrë masat dhe veprimet e duhura për reduktimin e rreziqeve në nivel të pranueshëm dhe për të evituar devijimin e proceseve nga ecuritë normale.
- Rekomandimi 4** Kryetari duhet të sigurojë se është hartuar një listë ku rreziqet janë identifikuar sipas niveleve dhe gjasave që ato mund të ndodhin, si dhe janë parashikuar masat si kundërpërgjigje nëse ato ndodhin. Gjithashtu, përgjegjësia për menaxhimin e rrezikut duhet të delegohet tek një përgjegjës i cili do të raportoj tek menaxhmenti dhe të sigurojë zbatimin e kërkesave në këtë fushë.

2.5.2 Raportimi Menaxherial

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Mirëpo është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 5 – Dobësi në Kontrollët Menaxheriale – Prioriteti i lartë

- E gjetura** Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të komunës ka nxjerrë në pah mangësitë në aspektin formal të raportimeve të brendshme (raportimet bëhen në baza javore në mënyrë verbale). Kjo sidomos ka ndikuar në raportim jo cilësorë të progresit të projekteve kapitale, shpërputhjet në mes planit buxhetor të shpenzimeve dhe arritjes së objektivave dhe mungesë e raportimit të pasurive në baza periodike.
- Rreziku** Cilësia e dobët e raportimit financiar dhe aktiviteteve operative tek menaxhmenti i lartë e ka reduktuar aftësinë e menaxhmentit për të reaguar me kohë ndaj dobësive të pranishme, si dhe ka ulur efektin e kontrolleve buxhetore.
- Rekomandimi 5** Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme.

2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) operon me dy anëtarë të stafit - Drejtori i NJAB dhe një auditor. NJAB kishte përgatitur planin e auditimit dhe e kishte aprovuar nga menaxhmenti i komunës. Kjo njësi kishte kryer shtatë raporte të auditimit aq sa i kishte planifikuar. Raportet e kryera nga NJAB ishin: Procedurat e prokurimit - 2014; të hyrat dhe shpenzimet - 2014; ndërsa raportet tjera si fusha rishikimi kishin vitin 2015, si: raport për të hyrat dhe shpenzimet në sektorin e arsimit, raport për QKMF; raport për të hyrat në drejtorinë e ekonomisë; raport për të hyrat në drejtorinë e bujqësisë dhe raport për të hyrat në drejtorinë e administratës.

Çështja 6 - Dobësitë e punës së Auditimit të Brendshëm dhe Komitetit të Auditimit - Prioritet i lartë

E gjetura Raportet e auditimit të kryera nga NJAB për fushën e prokurimit dhe drejtorinë e financave kishin fokus vitin 2014. NJAB nuk kishte programe të auditimit dhe i mungon një qasje e mirëfilltë e testimit. Dokumentimi i punës së NJAB nevojitet edhe më shumë të zhvillohet dhe të mbahen dëshmitë përkatëse për çdo çështje që ngritët në raportet e auditimit të brendshëm.

Plane të veprimit në shumicën e rasteve nuk ishin bërë nga njësitet e audituara dhe rekomandimet e auditimit të brendshëm nuk janë implementuar nga ana e menaxhmentit.

Komuna e ka të themeluar Komitetin e Auditimit (KA) që nga viti 2014, por ai komitet nuk ka qenë asnjëherë funksional.

Rreziku Auditimi i brendshëm nuk është duke ofruar sigurinë e duhur mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme gjatë vitit 2015. Dobësitë e paidentifikuara dhe të pa adresuara nga NJAB, mund të rezultojnë në humbje financiare për komunën.

Rekomandimi 6 Kryetari duhet të bëjë planin e veprimit, i cili duhet të zbatohet, duke i konfirmuar zyrtarët përgjegjës dhe kohën për kryerjen e veprimeve. Auditimi brendshëm duhet të ketë në fokus të veçantë aktivitetet në vitin aktual, me efekt parandalues të veprimit. Për të fuqizuar rolin e auditimit të brendshëm, Komiteti i Auditimit duhet të funksionalizohet.

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

3.1 Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të Qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi çertifikimin e pagesave në përgjithësi janë të dobëta dhe nuk janë duke u zbatuar në mënyrë efektive. Fushat tjera ku nevojiten më shumë përmirësime janë planifikimi i buxhetit, klasifikimi i duhur i shpenzimeve, procesi i menaxhimit të qiradhënieve, menaxhimi i kontratave si dhe menaxhimi i pasurive.

3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për komunën, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike si dhe të hyrat e arkëtuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – shpenzimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2015 Shpenzimi	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi
Burimet e Fondeve:	11,438,701	12,024,397	11,473,317	10,463,701	10,067,841
Granti i Qeverisë -Buxheti	10,339,687	10,558,529	10,403,275	9,530,093	9,148,202
Të bartura nga viti paraprak ² -	0	281,748	256,666	166,113	188,362
Të hyrat vetjake ³	1,099,014	1,099,014	746,922	737,857	680,000
Donacionet e brendshme	0	5,032	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	80,074	66,454	29,638	51,277

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 585,696€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve (85,106€), të hyrave të bartura (281,748€) si dhe grantit të Qeverisë (218,842€) pas rishikimit buxhetor.

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

Në vitin 2015 komuna ka shpenzuar 95% të buxhetit final, përafërsisht në shkallë të njëjtë me vitin e kaluar (96%). Në përgjithësi, kjo mund të konsiderohet një performancë e mirë e ekzekutimit buxhetor.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Shpenzimi	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	11,438,701	12,024,397	11,473,317	10,463,701	10,067,841
Pagat dhe Mëditjet	6,606,800	6,834,977	6,818,898	6,228,063	5,330,305
Mallrat dhe Shërbimet	656,191	781,899	771,189	634,577	693,593
Shërbimet komunale	295,000	285,000	280,665	226,174	271,208
Subvencionet dhe Transferet	150,000	150,151	142,160	105,951	93,845
Investimet Kapitale	3,730,710	3,972,370	3,460,405	3,268,936	3,678,890

Buxheti për kategorinë investime kapitale ishte shpenzuar në një nivel më të ulët se në kategoritë tjera (87%). Kjo kishte ndodhur për shkak se disa kontrata ishin lidhur në fund të vitit 2015. Po ashtu, në ekzekutim të ultë kishte ndikuar edhe dështimi i ekzekutimit të disa kontratave për shkak se punimet nuk ishin kryer sipas specifikave të kontratës dhe komisionet e pranimeve teknike nuk kishin pranuar punimet e ekzekutuara.

Tabela 3. Të hyrat vetjake për buxhetin e komunës - pranimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Pranimet	2014 Pranimet	2013 Pranimet
Të hyrat vetjake	1,099,014	1,099,014	969,696	1,017,555	842,364

Siç shihet nga tabela, të hyrat vetjake kanë shënuar një rënie në krahasim me vitin e kaluar për 47,859€. Kjo ka ndodhur për shkak se të hyrat e mbledhura nga gjambat në trafik dhe gjykatat ishin më të ulta se vitin e kaluar.

Çështja 7 – Ekzekutimi i buxhetit – Prioriteti i lartë

- E gjetura** Pasqyra e shpenzimit të fondeve nxjerrë në pah një nivel relativisht të ultë të ekzekutimit të buxhetit për investime kapitale. Vonesat në zhvillimin e procedurave të prokurimit kanë ndikuar në ngecjen e planit të shpenzimeve.
- Rreziku** Planifikimi i dobët i prokurimit, respektivisht lidhja e kontratave në fund të vitit ulë efektivitetin e komunës në realizimin e projekteve kapitale dhe shfaqjen e suficiteve buxhetore në fund të vitit.
- Rekomandimi 7** Qasja ndaj planifikimit buxhetor për projekte kapitale ka nevojë për përmirësime thelbësore. Para se të përcaktohen fondet për investime, komuna duhet të analizoj me kujdes dhe objektivitet se cilat projekte janë prioritare dhe cilat prej tyre kanë gjasa reale të realizohen. Procedurat e filluara me kohë (hartimi i projektit, sigurimi i ekzekutimit, prokurimi, etj.) janë disa nga parakushtet që projektet të realizohen sipas planit.

3.4 Prokurimi

Në fushën e prokurimit kemi rishikuar 15 procedura të prokurimit në vlerë totale 1,295,498€. (vlera e kontratave për investime kapitale 1,107,165€ dhe mallra dhe shërbime 188,333€). Rregullat e Prokurimit synojnë të sigurojnë se fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efikase për të arritur vlerën për para. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në menaxhimin e prokurimit. Kjo përfshin kërkesën për të ulur rrezikun në përfundimin e kontratave dhe ekzekutimin e tyre. Kjo arrihet përmes zbatimit të një regjimi të ndëshkimeve në lidhje me performancën e dobët si dhe përmes sigurisë së ekzekutimit.

Ne kemi analizuar projektet për investime kapitale në Tabelën 4.2 - Financimi i Investimeve Kapitale Komunale 2015-2017 dhe kemi vërejtur se si investime kapitale ishin të përfshira 441,900€.

Çështja 8 - Dobësi sistematike në prokurim - Prioritet i lartë

E gjetura

Në tri raste komuna ka hyrë në obligime më shumë se ndarjet buxhetore të parapara në tabelën 4.2 për projektet e caktuara kapitale. Rastet e tilla kanë të bëjë me: Projekti për ndërtimin e Shkollës në fshatin Apterushë sipas buxhetit 2015-17 ishte planifikuar 426,000€, ndërsa komuna kishte lidhur kontratë në shumë 537,489€; Projekti për ndërtimin e rrugëve në Rahovec ishte planifikuar me buxhetin e vitit 2015 në vlerë 374,408€, ndërsa kontrata ishte lidhur në vlerë 514,087€. Po ashtu, projekti "Rregullimin e qendrës së vjetër të qytetit me gurë" me buxhet 2015-2017 ishte planifikuar 185,480€, ndërsa komuna kishte nënshkruar kontratë 286,860€.

Komuna kishte realizuar 23 procedura (procedura të hapura dhe kuotim çmimeve) jashtë planit të prokurimit.

Në dy procedura të prokurimit "Mirëmbajtja e automjeteve" (vlera e parashikuar 50,000€) dhe "Furnizimi me inventar për nevojat e komunës" (vlera e parashikuar 120,000€) identifikua që deklarata e nevojave nuk ishte dorëzuar në AQP siç kërkohet me nenin 9 pika 6 e LPP-së. Po ashtu për këto dy procedura ishin përdorur afate të përshpejtuara të tenderimit me arsyetimin se njësia kërkuese është vonuar në planifikim dhe skadimit të kontratës paraprake. Kjo bie në kundërshtim me nenin 46 të LPP-së sipas të cilit mos planifikimi i nevojave komunale nuk e justifikon përdorimin e procedurës së përshpejtuar;

Për procedurën e prokurimit "Mirëmbajtja e automjeteve" kriter në dosje të tenderit ishte distanca maksimale e garazhës/punëtorisë të jetë jo më larg se 10 km. nga Autoriteti Kontraktues. Kjo është në kundërshtim me nenin 7 të LPP ku thuhet se Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë rrethana ose kushte që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet OE.

Zyra e prokurimit në gjashtë (6) raste nuk kishte njoftuar me shkrim OE të eliminuar nga tenderi. Sipas nenit 54 të LPP njoftimi do duhej të bëhet me shkrim dhe t'i tregoj arsyet për eliminim.

Në katër (4) raste të procedurave të prokurimit identifikua se në dosjet e tenderëve nuk ishin parashikuar sasi të përafërta ashtu siç parashihet me LPP dhe UA 02/2015. Te gjitha pozicionet ishin me sasi 1, ndërsa furnizimet ishin me sasi shumë më të larta se sa ishin specifikuar në kontrata.

Rreziku Hyrja e komunës në kontrata më shumë se sa ndarjet buxhetore të parapara me ligj të buxhetit, rritë rrezikun që projektet e tilla të vonohen, madje edhe të mos përfundohen. Përdorimi i procedurave të përshpejtuara pa ndonjë arsye bindëse dhe përdorimi i kritereve diskriminuese territoriale ndikojnë në zvogëlim të konkurrencës dhe favorizim të operatorëve. Mos respektimi i kritereve të kërkuara gjatë vlerësimit të ofertave rezulton me shpërblim të kontratës OE të pa përgjegjshëm dhe rritë rrezikun e pa përgjegjshmërisë në procesin e ekzekutimit të kontratës.

Rekomandimi 8 Kryetari duhet të kryejë një rishikim të brendshëm për të përcaktuar pse kërkesat e prokurimit nuk janë adresuar në të gjitha rastet e prokurimit dhe të ushtrojë më shumë kontrolle për të siguruar se dobësitë sistematike të identifikuar janë adresuar. Të siguroj se komuna nuk do të hyjë në obligime më shumë se sa ndarjet buxhetore të parashikuara me ligjin e ndarjeve buxhetore.

Çështja 9 – Dobësitë josistematike në prokurim – Prioritet i lartë

E gjetura Në projektin “Ndërtimi i rrugëve lokale në Rahovec” të kontraktuar në vitin 2013 në shumë 455,965€ identifikua që në procesin e ekzekutimit të punimeve ishin bërë ndryshime substanciale nga kushtet e kontratës. Në kontratën e nënshkruar ishin specifikuar 10 rrugët të cilat do të rregullohen. Përmes testimit të dy pagesave ne identifikua që rruga Vëllezërit Haradinaj dhe Mustafë Ibishi nuk ishte rregulluar ashtu siç ishte kontraktuar. Në vend të rrugës Mustafë Ibishi, menaxheri i kontratës kishte obliguar organin mbikëqyrës dhe OE që të rregullohen segmente të rrugëve tjera lokale të cilat nuk ishin në specifikacionin teknik të vitit 2013 (pa kontraktuar). Kjo është në kundërshtim me udhëzimin operativ të prokurimit publik neni 55.22 dhe 55.23 ku parashihet se ndryshimi i kushteve të kontratës do të përgatitet nga departamenti i prokurimit pas marrjes së aprovimit nga ZKA.

Rreziku Shtruarja e rrugëve të tjera lokale të cilat nuk kanë qenë të kontraktuara konsiderohet se është bërë jashtë të gjitha procedurave ligjore dhe administrative. Së këndejmi, përveç papajtueshmërisë ligjore, nuk është e qartë nëse është arritur vlera për para. Rastet e tilla mund t'i shkaktojnë komunës humbje financiare.

Rekomandimi 9 Kryetari duhet të sigurojë ta shqyrtoj rastin pse Menaxheri i Projektit nuk ka zbatuar kushtet e kontratës si dhe të siguroj se paramasat, parallogaritë dhe analizat tjera teknike për projektet që do të tenderohen, janë kryer në mënyrë të hollësishme, dhe devijimet nga kontratat fillestare të jenë brenda limiteve të lejuara. Pas shqyrtimit të rastit, ndaj personave përgjegjës të inicioj masa adekuate të përgjegjësive.

3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit

3.5.1 Pagesat tjera

Komuna kishte bërë shpenzime në bazë të disa marrëveshjeve të mirëkuptimit apo të bashkëpunimit. Si rezultat i planifikimit të dobët të buxhetit, komuna kishte shpenzuar shumën 122,834€ prej investimeve kapitale pa procedura të prokurimit duke u mbështetur në marrëveshje bashkëpunimi me Caritas Kosova. Kjo është në kundërshtim me nenin 21 të rregullës financiare 01/2013 për shpenzimin e parave publike, ku për çdo investim nevojitet procedurë e prokurimit.

Çështja 10 - Marrëveshje bashkëpunimi- Prioritet i lartë

E gjetura Kryetari me 24.02.2015 kishte lidhur Memorandum bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi me Caritas Kosova për ngritjen e cilësisë së shërbimit shëndetësor shtëpiak dhe ambulantor për qytetarët e Komunës së Rahovecit dhe në zonat rurale. Vlera e këtij projekti është 90,000€ dhe kohëzgjatja e tij është deri më 31.12.2015. Komuna sipas marrëveshjes participon me 75,000€. Caritas Kosova në kuadër të këtij projekti do të participon në vlerë 15,000€ me staf menaxhues dhe vetura për vizita në komunitete dhe material shëndetësor për përfituesit e projektit. Po ashtu, me 21.08.2015 komuna kishte lidhur aneks marrëveshje me Caritasin për ngritjen e numrit të stafit të planifikuar në marrëveshjen bazë. Sipas aneks marrëveshjes komuna do të paguaj në llogari të Caritasit shumën 48,627€ ndërsa kontributi i Caritasit do të jetë me staf menaxhues në vlerë monetare 5,000€. Komuna kishte paguar në llogari të Caritasit 122,834€ prej të cilave 65,980€ nga kategoria investime kapitale dhe 56,854€ nga kategoria mallra dhe shërbime, para se shërbimi të ofrohet. Këta punëtorë sipas të dhënave nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) ishin angazhuar në QKMF, QMF dhe në AMF nëpër zonat rurale. Po ashtu, komuna nuk ka ndonjë dëshmi bindëse për të siguruar se nëse mjetet e zotuar nga donatori (pjesëmarrja e donatorit) sipas marrëveshjes ishin shpenzuar për këtë projekt.

Rreziku Ekzekutimi i pagesave nga komuna para konfirmimit që shërbimet janë pranuar, shoqërohet me rrezikun potencial që objektivat e marrëveshjeve të arrihen pjesërisht apo edhe të mos arrihen. Derisa komuna nuk ushtron mbikëqyrje aktive në realizimin e projekteve dhe nuk posedon asnjë garanci se donatorët do të përfundojnë projektet sipas marrëveshjeve, këto pagesa mund të konsiderohen të parregullta dhe mund t'i shkaktojnë komunës dëme të konsiderueshme financiare.

Rekomandimi 10 Kryetari duhet të sigurojë se nuk do të bëj pagesa para se të konfirmohet se punimet apo shërbimet janë kryer. Pagesat duhet të jenë të dokumentuara me raporte të konfirmuara për pranimin e punëve/shërbimeve. Aspekti i mbikëqyrjes dhe raportimit të detyrimeve që dalin nga këto marrëveshje, duhet të jetë subjekt i shqyrtimeve të rregullta nga menaxhmenti i komunës. Për të eliminuar rrezikun për dështimin e këtyre marrëveshjeve, ne do të sugjerim që praktikat e tilla të pagesave të ndërpriten.

Çështja 11 – Kontrata për shërbime të veçanta- Prioritet i mesëm

E gjetura Komuna gjatë vitit 2015 kishte angazhuar 35 punonjës me kontrata për shërbime të veçanta. Pagesa për këto shërbime ishte bërë nga kategoria mallra dhe shërbime në shumë 43,404€. Në identifikuam 8 punonjës që ishin angazhuar në periudhë më gjatë se 6 muaj. Të njëjtit kanë qenë të angazhuar edhe në vitin 2014. Te gjitha kontratat ishin lidhur për pozita të zakonshme, e jo për ekspertë të fushave përkatëse dhe për të njëjtat nuk është zhvilluar procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit. Sipas ligjit të shërbimit civil afati i kontratave për shërbime të veçanta duhet të jetë më i shkurtër se gjashtë muaj.

Rreziku Lidhja e kontratave për shërbime të veçanta për më gjatë se 6 muaj është në kundërshtim me ligjin e shërbimit civil, dhe angazhimet për pozita të zakonshme ndikon në rritjen e shpenzimeve të shërbimeve kontraktuese dhe kjo tregon që shërbimet të mos jenë në përputhje me nevojat reale të komunës.

Rekomandimi 11 Kryetari duhet të rishikoj kontratat për shërbime të veçanta si dhe të siguroj që kontratat e tilla të përdorën vetëm për nevoja reale dhe jo të angazhohen për pozita të zakonshme.

3.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes sistemit të centralizuar qeveritar (payroll). Kontrollat që operojnë në nivel lokal kanë të bëjnë me: a) autorizimin e listës së pagave; b) verifikimin e ndryshimeve të mundshme; dhe c) rishikimin e buxhetit për këtë kategori.

Çështja 12 - Pagesat për kujdestari në shëndetësi - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Gjatë rishikimit të kujdestarive në QKMF identifikua që është tejkualuar numri i ndërrimeve të natës dhe orëve shtesë. Sipas kërkesës për veprim të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë me datë 17.07.2013 lejohen vetëm 8 ndërrime të natës brenda muajit ndërsa në 5 raste kemi vërejtur që ky numër është tejkualuar madje në disa muaj është dyfishuar. Gjithashtu, në një rast kemi vërejtur që numri i orëve shtesë të lejuara sipas ligjit të punës (8 orë në javë) është tejkualuar. Në disa muaj, norma e lejuar e orëve shtesë është tejkualuar mbi 100%.
- Rreziku** Tejkalimi i orëve shtesë dhe ndërrimeve të natës të lejuara përveç që është në kundërshtim me ligjin e punës, ndikon që të bëhen shpenzime të paparashikuara për paga.
- Rekomandimi 12** Kryetari duhet të sigurojë se do të bëhet një rishikim i orareve të kujdestarive në QKMF në mënyrë që të mos tejkalohej numri i orëve shtesë dhe të respektohet ligji i punës.

3.5.3 Subvencionet dhe Transferet

Buxheti i planifikuar për vitin 2015 ishte 150,151€ ndërsa ishin shpenzuar 142,160€. Ne kemi testuar 5 mostra në vlerë 17,000€ dhe nuk kemi hasur ndonjë parregullësi për tu raportuar.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.6 Të Hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna në 2015 ishin 969,696€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga lejet e ndërtimit, tatimin në pronë, të hyrat nga qiraja, taksat e biznesit, të hyrat nga niveli qendror etj.

Çështja 13 - Të hyrat nga qiraja dhe tatimi në pronë- Prioritet i mesëm

E gjetura Kuvendi Komunal me 29.04.2015 kishte nxjerrë një vendim për falje të borxheve për 50% bizneseve që i kanë në shfrytëzim lokalet komunale. Vendimi për falje i përfshinë 9 lokale të komunës. Sipas këtij vendimi bizneset obligohen të paguajnë paraprakisht 50% të borxhit me qëllim të shlyerjes së pjesës së mbetur në afat prej tre muajve, në të kundërtën të ndërpriten kontratat për shfrytëzim. Në tri raste shfrytëzuesit e lokaleve nuk kishin paguar borxhin sipas vendimit të Kuvendit Komunal (KK) dhe komuna nuk kishte marrë masat për ndërprerjen e kontratës. Për tri rastet e përmendura, obligimi që duhej shlyer pas faljes së borxheve ishte 27,050€, ndërsa shfrytëzuesit kishin paguar 19,550€.

Komuna nuk kishte arritur të kryej verifikimin e 1/3 e pronave të paluajtshme, siç kërkohet me ligjin për tatimin në pronën e paluajtshme nr. 03/L-204 dhe udhëzimin administrativ në fuqi (nr. 03/2011). Verifikimi ishte bërë vetëm për 978 prona apo 8% nga totali i tyre. Anketimi nuk ishte bërë për shkak të mungesës së zyrtarëve anketues.

Rreziku Mos respektimi i vendimit të KK rritë rrezikun që qiramarrësit të mos i përmbahen kushteve të kontratave për pagesën e borxheve. Vazhdimi i praktikave të tilla është precedent i keq dhe mund të nxis edhe obliguesit tjerë t'i shmangen pagesës së qirave. Mos verifikimi i 1/3 të pronave mund të rezultojë me mangësinë e informatave të plota të pronës së tatueshme aktuale.

Rekomandimi 13 Kryetari duhet të siguroi shkëputjen e kontratave ashtu siç e parasheh vendimi i KK për qiramarrësit të cilët nuk i kryejnë obligimet ndaj komunës. Në të ardhmen, të bëhet verifikimi i pronave komunale siç parashihet me ligj.

3.7 Pasuritë dhe detyrimet

3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Komuna gjatë vitit 2015 kishte trajtuar rekomandimin e vitit paraprak për regjistrimin e pasurisë por nuk kishte arritur ta implementoj në tërësi. Si rezultat i vazhimit të procesit të regjistrimeve, komuna kishte raportuar në PVF pasuritë në vlerë prej 52,206,159€, apo për 8,377,159€ më shumë, krahasuar me vitin paraprak. Megjithatë, deri në përfundimin e plotë të këtij, procesi nevojitet edhe shumë për t'u bërë.

Gjatë ekzaminimeve të mëtutjeshme, ne kemi vërejtur:

Çështja 14 - Mangësi regjistrimesh në regjistrat e duhur - Prioritet i lartë

E gjetura Regjistri i pasurisë nuk ishte i plotë dhe i saktë. Komisioni për vlerësim të pasurisë kishte evidentuar 234 parcela me sipërfaqe prej 12,072 hektar dhe 8 lokale afariste me 23,838m² të cilat janë në pronësi të komunës. Këto pasuri nuk ishin regjistruar në regjistrin kontabël, sepse nuk kishin vlerë financiare.

Gjatë vitit 2015 identifikua që komuna nuk kishte regjistruar në regjistrin kontabël 16 pagesa kryesisht të muajit dhjetor 2015. Vlera e totale e tyre ishte 352,871€. Përveç kësaj identifikua tri pagesa në vlerë 85,920€ që ishin regjistruar 2 herë në regjistrin e pasurisë.

Projekti për ndërtimin e oborrit të Shkollës në Drenoc i financuar nga IOM edhe pse ishte përfunduar, komuna nuk e kishte regjistruar në regjistrin kontabël të pasurisë. Vlera e projektit është 81,575€.

Lidhur me investimet në vijim, identifikua se shtatë projekte edhe pse kishin përfunduar, komuna nuk kishte azhurnuar regjistrin e pasurisë për t'i trajtuar si projekte të përfunduara.

Komisioni për vlerësim kishte vlerësuar se dy vetura ishin jashtë përdorimit, megjithatë ato ende figurojnë si pjesë e regjistrit të pasurisë komunale, me një vlerë financiare prej 969€.

Komuna në vitin 2015 kishte filluar të përdor regjistrin e E-pasurisë dhe në këtë regjistër vlera e pasurisë nën 1,000€ ishte 42,607€. Gjithashtu, në këtë regjistër nuk janë të përfshira pasuritë që janë në përdorim nga drejtorati i arsimit dhe shëndetësisë. Këto drejtori, pasurinë nën 1,000€ e kishin regjistruar në Excel, mirëpo kemi vërejtur që këto të dhëna nuk janë azhurnuar me pasuritë e pranuar në vitin 2015 sepse 19 pagesa për pranim të inventarit nga sektori i arsimit në vlerë totale 13,644€ nuk ishin regjistruar.

Rreziku Mos regjistrimi i plotë dhe saktë i të gjitha pronave vështirëson identifikimin e pasurive për të konfirmuar ekzistencën e tyre, si dhe rrit rrezikun që ato të keqpërdoren dhe ka ndikuar në nënvlerësim të pasurisë së komunës. Regjistrimi i mangët dhe i pa saktë i pasurive, bën që regjistri të jetë jo i besueshëm. Kontrollat jo efektive në menaxhimin e pasurisë kanë rezultuar në keq deklarim të pasurive.

Rekomandimi 14 Kryetari duhet që pa vonesë të formoj komisione kompetente për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të të gjitha pasurive jo financiare si dhe të monitoroj rezultatet e vlerësimit. Rezultatet e regjistrimit duhet të integrohen në një regjistër të vetëm për të gjithë sektorët. Procesi i regjistrimit të pasurive me vlera më të larta se 1,000€ në SIMFK, duhet të vazhdoj deri në regjistrimin përfundimtar. Zyrtari për menaxhim të pasurisë dhe zyrtarët e angazhuar në pranimin e pasurive komunale të komunikojnë në mënyrë efektive për të shmangur mos zbatimin e kërkesave të rregullores dhe mos konsolidimin e vlerës së pasurive.

3.7.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Llogaritë e arkëtueshme (L1 / A) të komunës në fund të vitit 2015 ishin 1,940,000€ dhe krahasuar me vitin paraprak (2,345,000€) ato janë zvogëluar për 405,000€. Arsyet e rënies së të arkëtueshmeve kanë rezultuar nga falja e borxheve në tatimin në pronë dhe nga falja e borxheve për të hyrat nga qiratë.

Çështja 15 - Trajtimi i llogarive të arkëtueshme - Prioritet i mesëm

E gjetura Ne rishikuam llogaritë e arkëtueshme dhe identifikuam që komuna nuk i kishte shpalosur ato në mënyrë të saktë në PVF. Diferenca e prezantuar më shumë në PVF është 3,777€, dhe si e tillë nuk konsiderohet materiale.

Me gjithë zvogëlimin e saldoeve të këtyre llogarive, shuma totale e këtyre llogarive prej 1,940,000€ paraqet një shumë të konsiderueshme, dhe si e tillë paraqet një potencial të mirë për të rritur burimet e vetëfinancimit të komunës.

Rreziku Mos arkëtimi i borxheve mund të ndikojë në mos përmbushjen e planit të shpenzimeve. Politikat jo efikase të komunës në trajtimin e këtyre llogarive, kanë rezultuar në rritjen e tyre të vazhdueshme dhe kjo rritë rrezikun e mos realizimit të projekteve komunale të planifikuara nga burimet vetjake.

Rekomandimi 15 Kryetari duhet të monitorojë në mënyrë sistematike çështjen e realizimit të të hyrave, për të siguruar se politikat dhe masat adekuate do të ndërmerren për të maksimizuar inkasimin e borxheve. Është e nevojshme që të bëhet një analizë e detajuar që përcakton arsyet e ngecjes së pagesave, si dhe të propozohen veprimet konkrete dhe burimet e nevojshme për mbledhjen e këtyre borxheve.

3.7.3 Trajtimi i borxheve

Komuna ka një rregullim të brendshëm lidhur me protokollimin e faturave. Ajo gjatë vitit 2015 kishte raportuar obligimet në Thesar në bazë të rregullta mujore. Shumat e obligimeve të raportuara në PVF 2015 janë 333,000€, ndërsa në vitin 2014 ishin raportuar 731,551€, ku vërehet një rënie e dukshme e gjendjes së këtyre llogarive.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të implementuar	Të adresuara por jo te implementuar	Të pa adresuara
2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Financiare (çështja 1)	Kryetari duhet të themeloj një komision të përbashkët, të përfaqësuar nga sektorët kryesor të komunës, në të cilin ne do të sugjerim edhe një zyrtar nga Drejtoria Komunale e Kadastrit, dhe të kompletoj regjistrimin e të gjitha pronave të paregjistruara. Ky komision duhet të përgatit një Raport përmbledhës ku do të raportoheshin rezultatet e regjistrimit dhe sfidat eventuale, dhe t'i paraqet menaxhmentit. Rol kyç në këtë proces duhet të ketë zyrtari i pasurisë, i cili duhet të bëjë regjistrimet e ofruara nga ky komision në SIMFK. Një monitorim sistematik i procesit ka nevojë të bëhet direkt nga Kryetari i Komunës.			X
2.3 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim. (Çështja 2)	Kryetari duhet t'i identifikojë arsyet për keq deklarimet e bëra në PVF dhe të siguroj se proceset e rishikimeve përfundimtare nga menaxhmenti do të përmirësohen kur PVF-të e vitit 2015 të dorëzohen. Kryetari dhe ZKF nuk duhet t'i nënshkruajnë deklaratat pa u siguruar se gabimet janë identifikuar dhe korrigjuar, para se PVF të dorëzohen në Qeveri.			X
3. Rekomandimet e vitit paraprake. (Çështja 3)	Kryetari duhet të sigurojë që plani i veprimit nuk do të bëhet sa për të plotësuar një kërkesë formale që del nga auditimi, por do të jetë një udhërrëfyes praktik për zbatimin e të gjitha rekomandimeve. Dokumenti si i tillë do të përcaktoj një afat kohor praktik si dhe personat përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve, me fokus fillestar në ato të një rëndësie të madhe. Zbatimi i këtij plani duhet të monitorohet nga vet Kryetari, dhe atë në baza të rregullta.		Po	

4.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit-pagesat e vendimeve gjyqësore. (Çështja 4)	Kryetari duhet të siguroj se do të bëj një planifikim të mirëfilltë të buxhetit, të forcoj disiplinën financiare për kryerjen e pagesave me kohë si dhe do t'i rishikoj të gjitha obligimet e prapa mbetura në mënyrë që të evitoj çrregullimet e tilla buxhet.		Po - pjesërisht	
5. Programi i investimeve publike (Çështja 5)	Kryetari duhet të sigurohet se për të gjitha projektet shumëvjeçare, planifikimi i buxhetit është bërë në mënyrë konsistente, dhe t'i përjashtoj të gjitha rreziqet që e shoqërojnë procesin.		Po- pjesërisht	
4.2 Inkasimi i qirave nga pronat komunale. (Çështja 6)	Kryetari duhet të siguroj që kushtet e arritura të kontratave me qiramarrësit, në mënyrë strikte të zbatohen. Për rastet që vlerësohet se qiratë nuk mund të mblidhen, kontratat të ndërpriten dhe të zbatohet institucioni i ankandit publik për dhënien e pronave në shfrytëzim subjekteve tjera që respektojnë kontratat.			X
7. Planifikimi i dobët i të hyrave nga tatimi në pronë (Çështja 7)	Me rastin e planifikimit të buxhetit potencial nga tatimi në pronë, Kryetari duhet të siguroj që procesit të planifikimit i paraprinë një analizë e trendeve të realizuara gjatë viteve të kaluara, me theks të veçantë niveli i faturimeve. Përveç kësaj, komuna duhet të zbatoj politika më efektive në mbledhjen e tatimeve, për të ruajtur kuotën minimale të tatimeve që nuk mund të inkasohen apo borxheve të këqija.		po	
4.3.1. Dobësitë sistematike në prokurim. (Çështja 8)	Kryetari duhet të zbatoj me kujdes procedurat e kontratave dhe kërkesat ligjore dhe të mos hyjë në obligime kontraktuale, para se fondet buxhetore të jenë zotuar. Zotimet afatgjata duhet të harmonizohen me dinamikën e projekteve dhe të planifikohen me Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) të komunës. Më tej, njësitë kërkuese të prokurimit duhet të kryejnë vlerësimet e përafërta për qëllime furnizimi/blerjeje në rastet e kontratave të tipit kornizë, dhe procedimi i shpenzimeve të bëhet sipas ndarjeve adekuate buxhetore.			X

9. Dobësitë jo sistematike në prokurim. (Çështja 9)	Kryetari duhet të siguroj zhvillimin e procedurave të prokurimit për të gjitha rastet kur kjo kërkesë është e aplikueshme.	Po		
10. Ndryshimi pozicioneve të kontratës gjatë ekzekutimit të punimeve. (Çështja 10)	Kryetari duhet të siguroj se paramasat, paralogaritë dhe analizat tjera teknike për projektet që do të tenderohen, janë kryer në mënyrë të hollësishme, dhe devijimet nga kontratat fillestare mund të jenë minimale. Kryetari të rishikoj këtë kontratë dhe të analizoj në detaje arsyet e ndryshimeve të pozicioneve dhe të ndërmerr masa të menjëhershme me qëllim që projekti të arrij qëllimin e përcaktuar.	Po		
4.3.2 shpenzimet tjera-pagesat përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit. (Çështja 11)	Para nënshkrimit të marrëveshjeve të ardhme, Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha kërkesat e LMFPD dhe rregullores së Thesarit 01/2013 për shpenzimin e parave publike janë marrë parasysh. Praktikantët e tilla të pagesave nuk duhet të përsëriten dhe rreziqet potenciale që i shoqërojnë këto pagesa, duhet të eliminohen në mënyrë të qartë me dispozitat e këtyre marrëveshjeve. Ndërsa, marrëveshjet në ekzekutim e sipër, duhet të monitorohen dhe të arrihet siguria se punimet/shërbimet si subjekt i marrëveshjeve janë ekzekutuar nga ana e partnerëve.			X
4.3.4 Subvencione dhe transfere (çështja 12)	Kryetari të siguroj zbatimin e rregullores së brendshme komunale për ndarjen e subvencioneve në mënyrë që aprovimet e subvencioneve mbi 2,000€ të bëhen nga kuvendi komunal.	Po		
4.4.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale (çështja 13)	Kryetari duhet të siguroj se në fund të vitit do të themeloj komisionet për inventarizim dhe vlerësim të pasurive, të cilët do të përgatitin raportet përfundimtare për menaxhmentin, dhe rezultatet e regjistrimit do të procedohen në regjistrat e pasurive nga ana e zyrtarit përkatës. Aktivitetet e komisioneve duhet të mbështeten dhe monitorohen në mënyrë sistematike nga ana e Kryetarit.			X

4.4.2 Llogaritë e arkëtueshme - (çështja 14)	Kryetari duhet të inicioj një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse, dhe duhet të siguroj vendosjen e një plani strategjik për zvogëlimin e llogarive të arkëtueshme.		Po	
4.3.7 Trajtimi i Borxheve-(çështja 15)	Kryetari duhet të siguroj që shërbimi i financave zbaton të gjitha kërkesat ligjore mbi regjistrimin dhe pagesën e faturave të pa paguara.	Po		
4.4 Sistemi i Auditimit të Brendshëm. (çështja 16)	Kryetari duhet të siguroj që NJAB do të bashkëpunoj ngushtë me rastin e hartimit të planit vjetor të punës. Fushat e identifikuara për rishikim duhet të jenë të bazuara në nivelin e rrezikut dhe të jenë për vitin aktual, si dhe të dakordohen paraprakisht. Kryetari gjithashtu duhet të forcoj masat e llogaridhënies së menaxherëve për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm			X